



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 336 Akti

**Nr. 335 Vendimi
Tiranë, më 14.1.2021**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 14.1.2021, në mjediset e punës së Komisionit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kostika Çobanaqi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. 631, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dëgjoi arsyetimin ligjor të relatores së çështjes, znj.Valbona Sanxhaktari, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Kostika Çobanaqi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Kostika Çobanaqi, iu është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 12.11.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” – nga i cili rezultoi se do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit dhe zgjodhën kryesues komisioneren Xhensila Pine.

3. Procesi i rivlerësimit, ndaj subjektit të rivlerësimit, ka filluar në respektim pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në datën 26.11.2020, Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ dhe i ka kaluar atij barrën e provës në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të shpjeguar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

4. Në datën 14.12.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është informuar nga subjekti i rivlerësimit se ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën e tij për dorëheqje, e cila është pranuar.

5. Në vijim Komisioni ka administruar shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2020, të KLGj-së, me të cilën përcillej vendimi nr. 631, datë 10.12.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. Kostika Çobanaqi”, për shkak të dorëheqjes së tij. Sipas këtij vendimi Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 61 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në kërkesën e z. Kostika Çobanaqi, për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin Kostika Çobanaqi.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

6. Në germën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

7. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

8. Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

9. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

10. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

11. Me anë të postës elektronike, është pyetur z. Kostika Çobanaqi nëse dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij për t’u dëgjuar në një seancë dëgjimore. Në datën 17.12.2020, z. Kostika Çobanaqi ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të dëgjohet në një seancë dëgjimore.

12. Me shkresën nr.*** prot., datë 13.01.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor na përcjell informacionin se ndaj Vendimit nr. 631, datë 10.12.2020, nuk është ushtruar ankim gjyqësor.

13. Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara me lart, trupë gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Kostika Çobanaqi, duhet të ndërpritet sipas nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës, pasi Komisioni nuk ka kompetenca për të vazhduar procesin e rivlerësimit, sepse subjektit të rivlerësimit i mungon cilësia subjektive, si një parakusht për procesin e rivlerësimit, duke qenë se subjekti nuk bën më pjesë as në kategorinë e subjekteve

që rivlerësohen, *ex officio*, dhe as të atyre në mënyrë vullnetare, pasi nuk e ka statusin subjektiv, sipas nenit 179/b, pika 4, e Kushtetutës.

14. Për sa më sipër, në referim të germës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt rivlerësimi mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

15. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës do duhet të zbatohet në tërësinë e saj duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

16. Ky është një qëndrim i unifikuar edhe i Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit “G”, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin “G”, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Kostika Çobanaqi, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (përfunduar në datën 31.12.2020).
2. Ndalimin e emërimit të z. Kostika Çobanaqi, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 14.1.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine

Kryesuese

Lulzim Hamitaj

Anëtar

Valbona Sanxhaktari

Relatore

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku